



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

---

Nr. 1258/4 Prot

Tiranë, më 7/11 /2013

URDHËR

Nr. 13 datë 07/11 /2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “**Intercom Data Service shpk**”.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 213 datë 10.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Intercom Data Service shpk**” me adresë, Rr. "Ismail Qemali" nr. 27, Ish Blloku, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni21);
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28);
- Transferimit ndërkombëtar i të dhënave personale dhe respektimi i detyrimeve ligjore në këtë fushë (neni 8 dhe 9).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues dhe vendosën në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi “**Intercom Data Service shpk**” ofron shërbime në fushën e telekomunikacionit (shitje telefonike) vetëm për kompani italiane. Gjatë shërbimeve që ofron kontakton vetëm me shtetas italian (që ndodhen në Itali). Numrat e telefonit për klientët italianë sigurohen nga kontraktorët italianë, në përputhje me legjislacionin italian të mbrojtjes së të dhënave personale. Gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për punonjësit shqiptarë.

Për kategorinë “punonjës”, kontrolluesi mbledh të dhëna personale si: *emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, gjinia, moshë, numri i telefonit, profesioni (CV, raport mjekoligjor, librezë pune, diploma)*. Këto të dhëna mblidhen nga personeli i burimeve njerëzore dhe administrohen në “Dosjen personale të punonjësit”, në përputhje me kodin e punës.

Të dhënat personale të punonjësve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për punonjësit lidhet me mbarëvajtjen e punës në kuadër të zbatimit të legjislacionit përkatës në këtë fushë.

Të dhënat personale të punonjësve të larguar mbahen në dosjet e tyre të punës për një afat të pacaktuar. Komisioneri vlerëson se në kuadër të zbatimit të nenit 5 (shkronja d ), të dhënat mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të punonjësve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi i ka marrë të gjitha masat e sigurisë fizike për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve të administruara në dosje.
- Personat që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe formularët e aplikimit për punë (të cilat përmbajnë të dhëna personale), nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale. Në kontratën e punës me punonjësit nuk parashikohet asnjë dispozitë mbi konfidencialitetin.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit (bazuar në formatin tip të hartuar nga KMDP).

Në kuadër të përpunimit ligjor të të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-surveimit (referuar Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi ka instaluar 6 kamera brenda ambjenteve të tij. Aksesin në të dhëna është i kufizuar vetëm për drejtorin dhe specialistin IT. Regjistrimet mbahen për një periudhë prej 2 ditësh dhe fshihen automatikisht.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video surveimit.

- Në ambientet e brendshme të survejuara me kamera nuk ka tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.
- Zyrat e hapura në të cilat punonjësit zhvillojnë aktivitetin e tyre janë të mbikëqyrura më anë të sistemit të kamerave CCTV. Qëllimi i mbikëqyrjes së këtyre ambienteve më sistemin CCTV është ruajtja e aseteve të kompanisë. Meqenëse këto zyra janë “të hapura” dhe kanë në ç’do kohë supervisor i cili mbikëqyr punonjësit, atëherë prezenca e sistemit të vëzhgim-monitorimit me kamera CCTV nuk është proporcionale me qëllimin e përpunimit.
- Personat që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

### URDHËROJ

1. Në zbatim të shkronjës c) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hiqen kamerat e vendosura në zyrat e punonjësve pasi kjo “masë sigurie” nuk është proporcionale me qëllimin e përpunimit.
2. Në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.11, datë 08/09/2011 mbi “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, të dhënat e punonjësve të administruara në dosje, të shkatërrohen pas përfundimit të marrëdhënies së punës. E njëjta gjë të ndodhë edhe me formularët e kërkesave të aplikimit për punë.
3. Në zbatim të nenit 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:
  - Personat që kanë akses në të dhënat personale të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
  - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë).

- Në ambientet e survejuara me kamera të vendosen tabela informuese (sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr.3 të cituar më sipër) lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
  5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**



REPUBLICI I SHqipërisë  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
TIRANË